



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.10.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rend i ditës

1. Miratimi i procesverbalit të datës 7.10.2020
2. Miratimi e kalendarit të punës për periudhën 19 tetor - 6 nëntor 2020
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në projektligjin “Për armët””.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Arben Kamami, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Carcani, Edlira Hyseni, Ralf Gjoni, Musa Ulqini, Ardiana Jaku.

Mungojnë:

Ilir Pendavinji, Sadri Abazi,

Të ftuar:

Besfort Lamallari – Zëvendësministër në Ministrinë e Brendshme

Albert Dervishaj - zv/ drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Përshëndetje të gjithëve!

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Do të fillojmë me listë-prezencën dhe më pas me rendin e ditës.

(Lexon emrat e deputetëve të Komisionit të Integritetit.)

Do të miratojmë procesverbalin e datës 7.10.2020.

Kush është dakord?

Miratohet.

Po ashtu, kemi miratimin e kalendarit për periudhën 19 tetor-6 nëntor 2020, që duhet ta keni në email.

Kush është dakord?

Faleminderit!

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në projektligjin “Për armët””.

Kemi prezentë përfaqësues nga Ministria e Brendshme, zëvendësministrin Besfort Lamallari.

Përpara se të fillojmë me prezantin e këtij projektligji, që do të na e bëjë zoti Lamallari, më lejoni t’ju kujtoj se, po ashtu, ne në kalendar kemi futur edhe buxhetin 202.

Pa humbur kohë do të ftoja zëvendësministrin për të na e prezantuar me projektligjin.

Urdhëroni, zoti Lamallari!

Besfort Lamallari – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Sot jemi mbledhur për projektligjin “Për armët”, i cili ka për qëllim kryesor përputhjen me objektivin nr.1 të strategjisë “Për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta 2019-2024”, ku përcaktohet që brenda vitit 2023 të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve dhe harmonizimi me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe e standartizuar edhe me detyrimet përkatëse në rajonin tonë.

Objektivat kryesore të kësaj nisme lidhen me rregullimin e çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, importimin, eksportimin, gjurmimin dhe transportimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të armëve të kategorive të përcaktuara, marrëdhëniet midis shtetit dhe subjekteve për pajisjen me arme dhe municione, marrëdhënia për lëshimin e licencave dhe autorizimeve përkatëse, ku Policia e Shtetit është institucioni përgjegjës për rregullimin e kësaj procedure dhe veprimtarinë e prodhimit, demilitarizimit, çaktivizimit dhe riparimit të armëve.

Objektivat që synohen të realizohen nëpërmjet miratimit të këtij projektligji janë përafrimi i ligjit ekzistues me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me direktivën e BE-së 2017, nr. 853 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, si dhe përafrimin e pjesshëm me Rregulloren e BE-së.

Do të doja të vlerësoja punën e bërë nga Drejtoria për Përafrimin e Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë, ku është përcjellë edhe opinioni, i cili ka qenë një trajtim shumë i kujdesshëm i kësaj nisme, i këtij projektligji. Janë shqyrtuar materialet në një kohë shumë të shkurtër nga personat përgjegjës të angazhuar me këtë projektakt.

Këtu kemi të pranishëm edhe përfaqësuesit e Policisë së Shtetit, zotin Albert Dervishaj, zëvendës drejtor i përgjithshëm, i cili mund të përgjigjet për çdo pyetje që mund të keni, si dhe do të japë edhe informacione shtesë nëse është e nevojshme.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Në këtë mbledhje kemi përfaqësues edhe nga Ministria e Mbrojtjes. Shoh se është i pranishëm zoti Elton Hodaj, përgjegjës i sektorit të regjistrimit të licencave pranë AKSHE-së.

Zoti Hodaj, mirë se erdhe në këtë mbledhje!

Unë do të doja, në fakt, që përpara se të fillonim të kishim të pranishëm zotin Kasneci, i cili mund të na fliste për këtë bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme.

Nga raporti që kam nga zoti Kasneci, shoh se janë të rakorduara opinionet e Drejtorisë për Përafrimin e Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë, që është gjë pozitive, por gjithësesi unë mendoj se mund ta hapim mbledhjen duke bërë pyetje përfaqësuesve të ministrive, të Brendshme dhe të Mbrojtjes, dhe më pas mund të kemi zotin Kasneci në lidhje që të na thotë më tepër për këtë opinion.

Kush ka dëshirë ta marrë fjalën?

Urdhëroni, zonja Mesi!

Senida Mesi – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, edhe unë do të doja të ishte zoti Kasneci për të na shpjeguar nëse është dakordësuar në lidhje me pikat që ka propozuar për ndryshim. Janë semantike nga njëra anë dhe nga ana tjetër, përkthim. Nuk e di nëse ka ndonjë koment nga institucionet përkatëse apo nga Ministria e Brendshme, nëse është dakordësuar me sugjerimet dhe rekomandimet e Drejtorisë për Përafrimin e Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë.

Ndërkohë, ne si anëtarë të këtij komisioni, kemi të depozituar pranë postës tonë elektronike edhe opinionin ligjor nga këshilluesit ligjor, në lidhje me projektligjin në fjalë. Nuk e di, zoti zëvendësministër, nëse ju keni komunikuar ose ju janë adresuar tri problematikat e evidentuara në lidhje me 3 nene. Këto janë edhe pyetjet e mia në lidhje me neni 5 të projektligjit, pika 2, shprehet që në pika 2, kategoria “D” të hiqet, ndërkohë i jemi referuar në nenin 4, llojet e armëve, ku thuhet: “Armët e kategorisë “D” janë...” dhe listohen 3 kategori armësh, D1, D2, D3. Duket sikur ky nen ka mbetur i pandryshuar.

Pra, do të vazhdojmë me nenin 5 të projektligjit, ku pika 2 hiqet dhe a ka nevojë të modifikohet edhe neni 4 për tipin dhe llojet e armëve? Kjo është pyetja e parë.

Në lidhje me dispozitën kalimtare, neni 38, thuhet se autorizimet e lëshuara për kategorinë “D”, para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme deri në përfundimin e afatit 5-vjeçar, pa të drejtë rinovimi.

Pyetja është: në nenin 38 të projektligjit për dispozitat kalimtare, kujt i referohet autorizimi i lëshuar për kategorinë “D”? Ka mospërputhje me nenin 5 të këtij projektligji ku thuhet: Në pikën 2, kategoria “D” të hiqet.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Kjo pyetje besoj se është për zotin zëvendësministër. Ndërkohë që ju jepni përgjigjen, do të doja të dija pak më shumë, meqenëse për momentin nuk e kemi këtu zotin Kasneci, me të cilin po kërkojmë lidhje, pra do të doja të dija më shumë se cilat janë risitë. Ju thatë se këto ndryshime vijnë si rrjedhojë e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, ndaj ma merr mendja se në këtë projektligj duhet të ketë edhe risi për sa i përket udhëzimeve të ndryshme që na japin direktivat e BE-së për të rregulluar përdorimin e armëve. Kësisoj, do të doja të dija në lidhje me risitë e këtij projektligji, ndërkohë që i jepni përgjigje edhe zonjës Mesi.

Ju faleminderit!

Fjala është për zotin Lamallari.

Besfort Lamallari – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja deputete!

Duke qenë se pyetjet e zonjës deputete ishin më teknike, zoti Dervishaj është në linjë dhe uroj të mos ketë probleme teknike, që të ketë mundësinë të detajojë më tepër lidhur me ndryshimet, me komente specifike për nenet përkatëse. Ajo që doja të theksoja edhe në diskutimet në komisionet e tjera parlamentare, konkretisht në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, janë marrë sugjerime përkatëse, të cilat janë dakordësuar nga ana jonë, që do të thotë se edhe Policia e Shtetit i ka shqyrtuar dhe vlerësuar, bashkë me opinionin e përcjellë, duke përfshirë edhe referencat në nenet përkatëse, të dërguara më herët nga Njësia e Përafrimit të Legjislacionit, në kuadër të kësaj mbledhjeje të ditës së sotme.

Më herët përmenda se është dakordësuar në parim. Vlerësojmë punën dhe komentet e bëra si në aspektin e teknikës legjislative, referencave të sakta në direktivën e ndryshuar dhe dispozitat përkatëse. Po ashtu, i gjithë materiali do të vijë i plotë, së bashku me tabelat e përputhshmërisë dhe referencat e korrektuara.

Për sa i përket çështjes se cilat janë risitë që sjell ky projektakt, dua të theksoj se janë bërë disa ndryshime, të cilat në thelb lidhen me rregullimin më të detajuar të forcimit të masave për dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse për veprimtaritë me armët, përmirësimin e sistemit të administrimit dhe regjistrimit të armëve në përdorim të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë. Këtu dua të theksoj se ka pasur kontribut jo vetëm puna e grupit të ngritur për këtë qëllim, por edhe ndihma e asistencës së vazhdueshme që kemi marrë nga UNDP, për të na asistuar edhe me data baze e regjistrat përkatës, për të pasur edhe një plotësim të detyrimeve të marra përsipër nga kjo nismë.

Gjithashtu, një tjetër çështje që adresohet përmes këtij projektakti, është edhe kërkesa për shkëmbim informacioni me vendet e Bashkimit Europian, në lidhje me armët e humbura e të trafikuarat.

Më konkretisht, nëse mund t'u referohem ndryshimeve në projektakt, ato lidhen me shtimin e disa përkufizimeve të reja, konkretisht neni 3. Janë ndryshuar llojet dhe kategorizimi i armëve, neni 4, janë shtrënguar, siç e përmenda më herët, rregullat dhe kriteret për pajisjen me armë, është thelluar gjurmimi i armëve të zjarrit nëpërmjet markimit, procesit të markimit dhe regjistrimit të të dhënave të armës, pra të blerësit dhe të përdoruesve, konkretisht nenet 8 dhe 9. Është shtuar një

kre i veçantë në lidhje me procedurën, kontrollin e transferimeve ndërkombëtare të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre.

Gjithashtu, është përcaktuar kufiri minimal dhe kufiri maksimal i moshës së personave që mund të pajisen me autorizim për mbajtjen e një arme zjarri, neni 27 i projektaktit. Është parashikuar dispozita e rekordeve kriminale, të cilat në fakt përbëjnë pengesë direkte për pajisjen me autorizim. Kjo do të thotë se ka një komision përgjegjës në Policinë e Shtetit, i cili vlerëson dhe kushtet e arsyt e dhëna për marrjen e një autorizimi të tillë. Në rast se verifikohet që ka probleme të karakterit ligjor penal të aplikuesve, kjo përbën shkak për mospajisjen me autorizim.

Gjithashtu, është parashikuar dispozita kalimtare e projektaktit për autorizimet dhe licencat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij projektligji, të cilat do të jenë të vlefshme deri në përfundimin e afatit të përcaktuar më herët. Këto lidhen me nenin 38.

Akti është konsultuar me të gjitha ministritë e linjës, përfshirë këtu edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rudina Hajdari – Ndërkohë na është bashkuar edhe zoti Kasneci.

Zoti Kasneci, do të donim të na bënit një prezantim në lidhje me opinionin që ju i keni dhënë zëvendësministrit, si dhe të na thoni se si jeni dakordësuar.

Ju lutem, hapni mikrofonin!

Dedë Kasneci – Dëgjohem më mirë tani?

Rudina Hajdari – Tani dëgjoheni.

Dedë Kasneci – Në rregull!

Tani, edhe një herë, përshëndetje të gjithëve!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Qëllimi kryesor i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për armët””, i vitit 2014, është përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar në fushën lidhur me armët e zjarrit, me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian.

Konkretisht, projektligji është përafruar me dy akte ligjore të Bashkimit Europian në këtë fushë. Është përafruar me direktivën e vitit 1991 “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimin e armëve”, si dhe është përafruar me një rregullore të Bashkimit Europian, të vitit 2012, e cila zbaton nenin 10 të protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit.

Neni 10 i protokollit të Kombeve të Bashkuara përcakton rregullat e përgjithshme për sistemin e licencimit dhe të autorizimit, le të themi, vetëm për eksportin ose importin e armëve në shtetet anëtare.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë protokoll në vitin 2008. Ky protokoll përbën për Republikën e Shqipërisë, le të themi, detyrim të dyanshëm. Jo vetëm si e drejtë ndërkombëtare e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, pasi është ratifikuar, por edhe si legjislacion i Bashkimit Europian.

Shërbimi ynë i Përafrimit e ka realizuar përputhshmërinë e projektligjit me nenet përkatëse të direktivës e të Rregullores. Për një përafrim më korrekt, në total kemi paraqitur tetë vërejtje.

Për ekonomi të kohës suaj, për eficiencë të kohës suaj, e nderuara zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, si gjithmonë ne i kemi diskutuar paraprakisht edhe me ekspertët e ministrisë dhe kemi gjetur dakordësi lidhur me vërejtjet tona.

Kaq kisha. Nëse na bëhet ndonjë pyetje më specifike, jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kasneci!

Zoti Gjoni ka një pyetje.

Po, zoti Gjoni, fjala është për ju!

Ralf Gjoni – Faleminderit! Dëgjohem, zonja kryetare?

Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë!

Zoti zëvendësministër, ju falënderoj për shtjellimin e propozimit tuaj në lidhje me projektligjin! Në parim jam dakord që ne duhet t'i përafrohemi legjislacionit të BE-së dhe standardeve bashkëkohore europiane, por kam dy pyetje, njëra prej të cilave lidhet me përafrimin me standardet e Bashkimit Europian, ndërsa tjetra me dinamikën e brendshme të terrenit shqiptar, që ndryshon dukshëm nga 99 % e vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

Së pari, a parashikoni ju ndërhyrje në legjislacion ose në iniciativa të Ministrisë së Brendshme, për sa i përket adresimit të problemit të madh të armëmbajtjes në Shqipëri? E kam fjalën për armët që tashmë janë në përdorim. Shqipëria ka një nga popullatat më të armatosura në Europë, e ndoshta dhe në botë, për frymë popullsie, dhe çfarëdo legjislacioni që ne të miratojmë në lidhje me blerjen dhe tregtimin e armëve të lehta në të ardhmen, duhet të trajtojmë me urgjencë situatën aktuale emergjente të Shqipërisë, ku ka një armëmbajtje të tmerrshme dhe rrezikohet jashtë mase rendi publik dhe jeta e qytetarëve shqiptarë. Të gjithë sot, teksa i japin makinës në

rrugët e Tiranës, apo kudo, mjafton një konflikt i vogël me një idiot tipik të rrugës, të cilët ne i kemi me bollëk këtu në Shqipëri, mund të degjenerojnë në një konflikt të armatosur, gjë që nuk ndodh në vendet e tjera të BE-së. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë, që është ndoshta më relevante me propozimin tuaj, është: a e keni parashikuar ju marrjen e masave për kryerjen e testeve psikologjike, mjekësore të çdo kandidati, që dëshiron të mbajë armë, apo që aktualisht mban armë në Republikën e Shqipërisë?

Kjo është një nga fushat ku po punohet në shumë vende anëtare të BE-së, një person që nuk është në rregull nga trutë, e thënë popullorçe, nuk duhet të mbajë armë. Është shumë e thjeshtë. Personalisht kam bindjen që në Shqipëri kemi një masë shumë të madhe të popullsisë sonë të patestuar psikologjikisht, e shohim në rrugë, në jetën e përditshme, në mënyrë anegdodale, njerëzit kanë një acarim, të cilin t'i nuk e shoh në vende normale, me popullsi normale, me shtete normale, me rregulla normale dhe me polici normale. Për këtë arsye a keni parashikuar ju që të krijohet një sistem kombëtar i kryerjes së testeve psikologjike dhe mjekësore përpara se një person, ndoshta i çmendur nga trutë, të mbajë armë në Republikën e Shqipërisë?

Faleminderit, zonja kryetare!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Gjoni!

Zëvendësministër, fjala është për ju.

Besfort Lamallari – Faleminderit, zoti deputet!

Sigurisht, përafrimi i ligjit shqiptar me atë të BE-së është edhe një nga misionet e kësaj nisme, edhe detyrim në kuadër të MSA-së, por, mbi të gjitha, kjo përputhet me vullnetin e qeverisë shqiptare për të adresuar çështje, që lidhen me sigurinë dhe përmirësimin e parametrave të sigurisë në vend, përfshirë edhe problematikat që lidhen me armët e zjarrit.

Ka pasur, në fakt, disa nisma, krahas kësaj nisme, që kontribuon edhe në këtë drejtim, pikërisht duke forcuar, siç përmenda edhe më herët, kriteret për pajisjen me armë zjarri, duke përcaktuar qartë edhe detyrat e komisionit për vlerësimin përpara dhënies së autorizimeve. Duke qenë se për këtë është një institucion përgjegjës, Policia e Shtetit, edhe ne kemi përfaqësues, mund të detajojnë më tepër lidhur me kriteret që vlerësohen nga komisioni për dhënien e këtyre autorizimeve. Ka pasur, gjithashtu, nisma për ashpërsimin e ligjit penal lidhur me armëmbajtjen pa leje. Pikërisht, procesi i regjistrimit, i markimit, i gjurmimit, i kontrollit të plotë të posedimit të këtyre armëve të zjarrit, qoftë nga persona fizikë, apo juridikë, i cili përmirësohet ndjeshëm përmes këtij projektakti, i shërben në finale atij shqetësimi, që ju ngritët, zoti Gjoni. Për këtë dua të them

edhe një herë se, krahas angazhimeve përpara BE-së, Shqipëria ka angazhimet e qeverisë shqiptare, ka angazhimet e marra edhe në kuadër të veprimtarive dhe nismave rajonale, është bërë një punë kolosale në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të strategjisë për armët e vogla dhe të lehta, një nismë franko-gjermane, ku Shqipëria jo vetëm ka raportuar në mënyrë periodike lidhur me detyrimet e përcaktuara për të gjitha vendet e rajonit, por ka marrë edhe asistencën logjistike dhe në ekspertizë për përmirësimin e kapaciteteve, që janë të angazhuara drejtpërdrejt me këtë luftë.

Nëse mundet, zotit Dervishaj t'u përgjigjet pyetjeve të zonjës Mesi.

Rudina Hajdari – Po, zoti zëvendësministër, e shoh që kemi zotin Dervishaj, i cili mund të japë më shumë shtjellim për sa u përket pyetjeve që bëri deputeti Gjoni.

Zoti Dervishaj, mirë se keni ardhur!

Fjala është për ju.

Albert Dervishaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Është kënaqësi që marrim pjesë në diskutimin e një projektligji shumë të rëndësishëm në komisionin parlamentar. Shkurtimisht, unë do t'i marr disa pyetje me radhë, sipas çështjeve që shtruan deputetët.

Zonja Mesi bëri një pyetje për nenin 5 dhe unë dua ta sqaroj se, edhe me sugjerimin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, është korrigtuar ky nen, duke hequr nga ky projektligj të gjitha nenet apo pikat ku është parashikuar shkronja “d” e ligjit për sa i përket llojit të armës, dhe mendojmë se është ezauruar. Ne e kemi konsultuar dhe kemi rënë dakord me sugjerimin e komisionit.

Lidhur me opinionin paraprak dhe me risitë e reja që sjell ky projektligj, që zëvendësministri, zoti Lamallari, tha, dhe unë nuk dua ta përsëris përgjigjen, do të ndalem te tri pyetje të deputetit Gjoni, lidhur me ndërhyrjet në legjislacionin për armëmbajtjen, blerjen dhe tregtimin e armëve etj. Këtë moment dua ta sqaroj në dy plane: së pari, sikurse e tha zëvendësministri, lidhur me armët që mbahen pa leje Kodi Penal është ndryshuar dhe ndryshimet kanë hyrë në fuqi në muajin nëntor të vitit 2019, duke i ashpërsuar dënimet për personat që mbajnë armë pa leje. Së dyti, në kuadër të strategjisë kombëtare të armëve të vogla dhe të lehta, që ka miratuar qeveria shqiptare në shkurt të vitit 2019, vendi ynë është i përfshirë në iniciativën rajonale të Ballkanit Perëndimor lidhur me kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, si dhe kemi edhe një

plan veprimi, në të cilin janë përcaktuar detyrat e të gjitha institucioneve. Kemi një rol aktiv në rajon në kuadër të iniciativës franko-gjermane dhe në plotësimin e detyrimeve në këtë kontekst. Në këtë strategji është parashikuar që në një moment të përshtatshëm të zhvillohet edhe një amnisti lidhur me dorëzimin vullnetar të armëve të vogla e të lehta, të cilat mbahen pa leje nga shtetasit në Shqipëri.

Projektligji dhe ligji ekzistues parashikojnë masa efikase lidhur me përshtatshmërinë e personave që duhet të mbajnë armë me leje. Qëllimi i draftit që paraqitet sot në komision është që, pikërisht, kriteret e shtetasve, të cilët do të pajisen me armë me leje të jenë sa më të ashpra, të mos jenë liberale. Ky është një nga qëllimet dhe prandaj janë parë disa nga kushtet që duhet të plotësojë një shtetas për t'u pajisur me armë zjarri.

Për sa u përket testeve psikologjike, mendoj se është e zgjidhur, sepse neni 35 i ligjit parashikon raportin mjekësor, është e përcaktuar edhe me një akt nënligjor, një udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku çdo shtetas duhet të paraqesë raportin mjekësor gjatë aplikimit për t'u pajisur me armë zjarri. Ai duhet të bëjë teste jo vetëm nëse ai është mendërisht në rregull, por edhe nëse është përdorues i alkolit, apo i drogave. Gjithashtu, kemi një kriter tjetër, që depozitohet në sistem gëzhoja e çdo arme që të kontrollohet përdorimi i saj në çdo rast në mënyrë të kundërligjshme. Nga statistikat që kemi ngjarjet kriminale, që vijnë nga armët që janë dhënë deri tani me leje, janë thujse zero, po them, sepse ka pasur ndonjë ngjarje të rrallë, kryesisht me armët e gjuetisë, që ka ndodhur nga pakujdesia. Gjithsesi, Policia e Shtetit, strukturat qendrore dhe vendore të saj kanë mbajtur qëndrimin e menjëhershëm ligjor ndaj këtyre rasteve, duke revokuar autorizimet për mbajtjen e armëve nga këta persona.

Faleminderit!

Rudina Hajdari -Faleminderit, zoti Dervishaj!

Fjalën e ka zoti Çaçani!

Arlind Çaçani - Faleminderit!

Edhe unë i përshëndes përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Drejtorisë së Policisë dhe e vlerësoj që ky ligj duhet. I bashkohem diskutimit të zotit Gjoni, që ne mund të jemi një nga popujt më të armatosur në Europë apo botë. Unë nuk jam i mirinformuar sesi veprohet me dorëzimin e armëve, por zëvendës drejtori tha që duhet të këtë një fushatë për dorëzimin vullnetar.

Si veprohet në këto momente, a lejohet dorëzimi vullnetar dhe çfarë masash merren? Mua më duket e udhës që duhet të ketë një fushatë që dorëzimi vullnetar të jetë në një kohë më të gjatë.

Për sa i përket pyetjes që kisha përgatitur, zëvendës drejtori e shteroi atë, sepse doja të dija: sa është numri i veprave penale që kryhen me armë zjarri në Shqipëri, të cilës zoti zëvendës drejtor i dha përgjigje. Kaq kisha

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni- Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Dervishaj, ju falënderoj për përgjigjen tuaj goxha informuese!

Dua të ndalem te një pikë që ju përmendet, te raporti mjekësor. Si kryhet ky raport mjekësor, te mjeku i lagjes? Pra, a bëhet fjalë për të njëjtin raport mjekësor që marrin mësuesit për të dhënë mësim, sepse ne e dimë shumë mirë sesi merren këto raporte mjekësore dhe se çfarë evaluimi dhe joevaluimi ekziston sot në sistemin shëndetësor shqiptar për sa i përket testimin dhe raporteve mjekësore të personave të ndryshëm? Apo kryhet ky në një laborator specifik të monitoruar nga Policia e Shtetit, me mjekë më të specializuar, të cilët kanë edhe një lloj garancie në raportet që lëshojnë për sa u përket njerëzve që mbajnë armë?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zoti Dervishaj, fjala është për ju.

Albert Dervishaj - Faleminderit, zonja kryetare!

Për t'iu përgjigjur pyetjes së zotit Gjoni, dua të them se raporti mjekësor është një modelar i përcaktuar në rregulloren e përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale. Personi që aplikon për t'u pajisur me armë zjarri duhet të plotësojë këtë raport mjekësor në një komision të përcaktuar në qendrën shëndetësore të lagjes. Ky komision është shumë i përgjegjshëm për të dhënë një verdikt sa më pranë realitetit të gjendjes shëndetësore të këtij shtetasi. Përveç kësaj, ne bëjmë një verifikim të dyfishtë, ku Policia e Shtetit, në zbatim të detyrës së saj, në kuadër të ligjit "Për Policinë e Shtetit", për çdo shtetas që kërkon të pajiset me armë zjarri përpilon një dokument që quhet vërtetimi i besueshmërisë, ku inspektori i Policisë Kriminale të zonës bashkë me inspektorin e Policisë së Rendit të zonës verifikojnë në burimet e tyre gjendjen shëndetësore dhe psikologjike të personit, jo vetëm sa i përket veprimtarisë së tij kriminale, por edhe japin një mendim nëse është i aftë mendërisht, sa e njohin njerëzit në zonë, sa e njeh policia dhe a ka historik të një ngjarjeje apo konflikti që mund të ketë bërë. Ne, prej vitesh

e respektojmë këtë procedurë dhe janë filtruar disa shtetas, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për të marrë armë. Jo të gjithëve që bëjnë aplikimin u jepet armë për ta mbajtur në banesë apo në lëvizje, në rastet kur u kërcënohet jeta, që janë shumë të paktë.

Faleminderit!

Ralf Gjoni- Të falënderoj, zoti Dervishaj!

Rudina Hajdari- A ka pyetje të tjera nga deputetët? Nuk ka.

Atëherë, e hedhim në votim. Sugjeroj që të ndjekim praktikën që kemi ndjekur gjatë kësaj kohe dhe të biem dakord për mënyrën e votimit. A jeni dakord që të votojmë në parim, nen për nen në paketë, me të gjitha sugjerimet që ka bërë zoti Kasneci, i cili është rakorduar me Ministrinë e Brendshme dhe më pas në tërësi?

Atëherë, e hedhim në votim në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju kujtoj që komision përgjegjës është Komisioni i Sigurisë, ndërsa ne jemi komision për dhënie mendimi, pra për të dhënë opinionin tonë për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së.

Para se ta mbyll mbledhjen, më lejoni të falënderoj zëvendësministrin për pjesëmarrjen, zotin Dervishaj dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes.

Jeni të lirë të largoheni, ne do të vijojmë me votimin.

Kalojmë në votimin nen për nen.

A jeni dakord me propozimet e bëra nga zoti Kasneci, të cilat do t'i hedhim në votim nen për nen në paketë, me ndryshimet e zotit Kasneci, janë 40 nene? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi, me të gjitha ndryshimet e propozuara nga zoti Kasneci. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kolegë, faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Senida Mesi- Për procedurë. Ju thatë që do të aprovojmë edhe kalendarin për projektbuxhetin dhe në lidhje me këtë, të cilën duhet të miratojmë dhe ta kalojmë në diskutim, unë kam një sugjerim për shërbimet dhe sekretariatit e komisionit. U përmenden dy data, 30.10 dhe 20.11, për trajtimin dhe miratimin në parim dhe nen për nen të buxhetit 2021, por nuk shoh se me cilën nga ministritë është takimi dhe propozimi im është që të kemi një dëgjësë me Ministrinë për

Europën dhe Punët e Jashtme dhe me Kryenegociatorin për çështjet e buxhetimit që merren me procesin e negociatave.

Rudina Hajdari - Jemi dakord me propozimin tuaj dhe në parim do ta diskutojmë me Ministrinë e Financave dhe nën për nën me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA